

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit, Nora Bllaca Dula kryetare, Gëzim Llulluni dhe Albert Zogaj anëtarë, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit Z.M., nga Prishtina, kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson H.I. jurist pranë të paditurës, për kompensimin e diferencës në pagë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1019/12 të dt.26.05.2014, në seancën e kolegjit e mbajtur me dt. 5.09.2017 mori këtë

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.a. në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.780/14 i dt.11.02.2015, në pjesën me të cilën është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është anuluar Aktvendimi i të paditurës Nr. 01-1040-373/12 i datës 07.03.2012, VËRTETOHET.

II. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, sh.a. në Prishtinë, PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1019/12 i dt.26.05.2014, në pjesën e kërkesëpadiës me të cilën është detyruar e paditura që paditësit t'i paguajë ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 9 dhe 7, për çdo muaj duke filluar nga data: 01.02.2012 e në muajt në vazhdim sipas kontratës së punës me të cilën paditësi te e paditura ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, me kamatë ligjore prej 4% duke filluar nga data 01.02.2012 e deri në pagesën definitive, si dhe pjesa e kërkesëpadiës për shpenzimet e procedurës dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe vendosje në këtë pjesë.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në paragrafin I të dispozitivit aprohet në tërësi e bazuar kërkesë padia e paditësit Z.M. nga Prishtina, Anullohet aktvendimi i të paditurës Postës dhe Telekomunikacioni i Kosovës nr.01-1040-373/2012 i datës 07.03.2012, DETYROHET e paditura që paditësit t'i paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës

9 dhe 7, për çdo muaj duke filluar nga 01.02.2012 e në muajt në vazhdim sipas kontratës së punës me të cilën paditësja te e paditura ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, me kamatë vonesë prej 4% nga data 01.02.2012 e deri në pagesën plotë në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcenim të përmbarrimit me dhunë. Me të njëjtin aktgjykim në paragrafin II të dispozitivit, është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të hudhet e pasafatshme padia dhe kërkesëpadija e paditësit ose ankesa e te paditurës të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ashtu që të refuzohet si e pabazuar padia dhe kërkesëpadija e paditësit, ose të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës dhe të priset aktgjykimi i atakuar dhe lënda t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoj shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre konform me dispozitat e nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditësit, kundër të paditurës, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka marrë aktgjykimin e atakuar. Në procedurën e të provuarit ka administruar provat dhe ka vërtetuar gjendjen faktike.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: sipas kontratës së punës të lidhur në mes të paditësit si punonjës dhe të paditurës si punëdhënëse, paditësi në cilësi të punëmarrësit ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar me të paditurin në vendin e punës Zyrtar për logjistikë në Njësinë Vala në Prishtinë, (neni 2 i kontratës), ndërsa të njëjtës i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen në lartësi të gradës 7 (shprehimisht parashihet në nenin 5 të Kontratës së punës).

Me aktvendimin e të paditurës me numër 01-1040-373 /2012 të datës 07.03.2012, paditësit i cakton të ardhurat personale mujore në lartësi të gradës 7 sipas strukturës së gradave, duke i ulur paditësit gradën e të ardhurave personale nga grada 9 në gradën 7 duke filluar prej datës 01.02.2012 e tutje, duke e konsideruar këtë aktvendim si pjesë përbërëse të kontratës së punës, me këshillë juridike dhe se ky aktvendim mund të atakohet në Komisionin e Ankesave në afat prej 8 ditësh.

Paditësi kundër këtij aktvendimi të datës 07.03.2012 ka ushtruar ankesë me datën 20.03.2012, për shkak të shkeljeve të vendimit të menaxhmentit të PTK sh.a, shkeljes së kontratës së punës, shkeljeve të dispozitave të Ligjit të Punës në Kosovë, shkeljeve të dispozitave të Kodit Penal të Kosovës dhe shkeljeve të dispozitave të Ligjit të Procedurës Administrative me detaje tjera si në ankesë. Në ankesën e paditësit e paditura nuk ka dhënë ndonjë vendim apo përgjigje në formë të shkruar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar të paditurës, me të cilin vendim paditësit i është ulur grada e të ardhurave personale nga grada 9 në gradën 7, ndërkaq, në pjesën arsyetuese gjykata e shkallës së parë, ka përshkruar përmbajtjen e dispozitave ligjore, si dhe dispozitën e nenit 5 të Kontratës së Punës të punësuarit, tani paditësit dhe bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike dhe dispozitat e sipërcekura ligjore, gjykata e shkallës së parë ka konkluduar se kërkesë padia e paditësit është e bazuar, duke dhënë arsyetimin përkatës, në pjesën arsyetuese në aktgjykimin e atakuar.

Këtë gjendje faktike të çështjes Gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitat e nenit 11, 11.1, 55 dhe 87 të Ligjit të Punës numër 03/L-2012 e lidhur me nenin 3 të Kontratës së Punës dhe nenin 186 dhe 277 të LMD-së, si dhe nenit 450 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se, pretendimet ankimore të të paditurës, lidhur me atë se aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, është pretendim pjesërisht i bazuar, me arsyetim se gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave, të cilat i ka pasur në dispozicion, ka marr aktgjykimin e drejtë sa i përket anulimit të aktvendimit të të paditurës për uljen e pagës nga grada 9 në 7, i cili është arsyetuar tërësisht në pjesën arsyetuese të tij dhe në këtë rast sa i përket kësaj pjese, aktgjykimi si i tillë nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të nenit 182 par. 2 pika n) të LPK, për të cilat pa të drejtë pretendohet nga e paditura, e as shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar, e për të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare konform nenit 194 të LPK. Po ashtu gjykata e shkallës së parë me rastin e anulimit të Aktvendimit të paditurës nr.01-1040-373/2012 të datës 07.03.2012 drejtë ka zbatuar ligjin material dispozitat e nenit 11 të Ligjit të Punës.

Pra pretendimet e tilla të përfaqësuesit të paditurës, për pjesën e vërtetuar, të cekura në ankesën e ushtruar, nuk kanë ndonjë mbështetje në prova konkrete, te cilat do te ndikonin që gjykata e shkallës së dytë, të detyrohet që të merr ndonjë vendim ndryshe, nga ai të cilin e ka marr gjykata e shkallës së parë, sa i përket pjesës të vërtetuar me këtë aktgjykim, meqë aktgjykimi është i plotë dhe i kuptueshëm dhe se në pjesën arsyetuese ka arsye të plota dhe konkrete mbi faktet relevante dhe se nuk ekziston kurrfarë kundërthënie në mes të dispozitivit të aktgjykimit dhe arsyeve të dhëna.

Për Gjykatën e shkallës së parë, siç rezulton nga shkresat e lëndës, ishte bazë e mjaftueshme Kontrata e Punës e lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse në kohë të pa caktuar dhe në bazë të kësaj kontrate, paditësit i është përcaktuar grada konform dispozitës së nenit 55 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, në të cilën kontratë, është përcaktuar e drejta për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat tjera i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin, për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë të përcaktuar me kontratën e punës. Në rastin konkret paga e paditësit sipas kontratës së punës është përcaktuar më nenin 3 të Kontratës dhe atë në lartësi të gradës 9, gjersa paditësit i është ulur në gradën 7 dhe atë me aktvendimin mbi caktimin e lartësisë së të ardhurave personale nr.01-1040-373/2012 të datës 07.03.2012. Prandaj, sipas Gjykatës së Apelit vlerësohet se vendimi i tillë i të paditurës, ishte në kundërshtim me dispozitat ligjore në fjalë.

Nga kjo rezulton se ulja e gradës, është në kundërshtim më dispozitat e nenit 3 të Kontratës së Punës të paditësit dhe Ligjit të Punës, ndërkaq kërkesa e aksionarit Qeverisë së Republikës së Kosovës-Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, lidhur me uljen e shpenzimeve operative te e paditura në raport me të hyrat e përgjithshme nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditësit, pasi që në rekomandimin e Qeverisë nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative, e as që thuhet për uljen e pagave dhe se e paditura është dashur të paraqiste një plan të detajuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve duke i precizuar ato. Gjykata e Apelit vlerëson se i punësuar ka të drejtë në pagë e cila i caktohet të punësuarit me kontratë të punës në pajtim me Ligjin e Punës, Kontratën Kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditësit sipas kontratës së punës ka qenë sipas gradës 9, prandaj ulja e pagës nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe të Ligjit të Punës. Pastaj, nuk ka asnjë provë se e paditura ka bërë ndërhyrjen në aktet normative të saj, lidhur me zvogëlimi e gradave dhe se nuk mund të bëhet kjo më një vendim të Drejtorit Menaxhues.

Prandaj, Gjykata e Apelit vlerëson se, Gjykata e shkallës së parë në situatën konkrete më të drejtë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar aktvendimin e të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës me nr. 01-1040-373/2012 të datës 07.03.2012, për zvogëlimin e gradës

së punës për paditësin prej 9 në 7, pasi që aktgjykimi i tillë në këtë pjesë nuk është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 194 të LPK.

Është i paqëndrueshëm pretendimi ankimor se padia dhe kërkesë padia e paditësit është e pasafatshme, sepse sipas nenit 87 të Ligjit të Punës të Kosovës në mënyrë eksplicite është përcaktuar se “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Prandaj në rastin konkret aktvendimi i të paditurës i cili kërkohet të anulohet është i datës 07.03.2012 ndërsa padia në Gjykatë është paraqitur nga paditësi në datën 03.05.2012 kështu që e njëjta është paraqitur brenda afatit 3 vjeçar.

Mirëpo, Gjykata e Apelit nuk mund ta pranon qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm, për pjesën gjyquese të dispozitivit, në të cilën detyrohet e paditura që paditësit t'i paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 9 dhe 7, me që në këtë pjesë aktgjykimi është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, pasi që aktgjykimi i shkallës së parë si i tillë në këtë pjesë, është i paqartë në dispozitiv dhe në kundërshtim me arsyetimin e dhënë, me që në dispozitiv nuk është përcaktuar lartësia e këtij ndryshimi të pagës, të bonusit dhe të trustit në mes të këtyre gradave që duhet paguar e paditura.

Një aktgjykim i tillë në këtë formë të përshkruar nga gjykata e shkallës së parë, nuk mund të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme. Po ashtu edhe kërkesë padia në këtë drejtim ka qenë e pa rregullt. Për shkak të këtyre shkeljeve thelbësore procedurale, edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht sa i përket kësaj pjese.

Në rigjykim për këtë pjesë të kërkesë padisë, gjykata e shkallës së parë duhet të ftoj palën paditëse që të bëjë precizimin e kërkesë padisë dhe në lidhje me këtë gjykata e shkallës së parë pastaj do të nxjerrë prova për të vërtetuar konkretisht dhe saktësisht se cila është lartësia e ndryshimit të pagës të bonusit dhe trustit në mes të këtyre gradave, si dhe periudhën kontestuese, për të cilën kërkohet kjo diferencë dhe pas administrimit të provave tjera nga shkresat e lëndës dhe vlerësimit të drejtë të tyre për këtë çështje, do të vendosë në mënyrë meritore.

Meqë aktgjykimi nuk është goditur me ankesë në paragrafin II të dispozitivit në këtë pjesë aktgjykimi nuk është shqyrtuar.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par. 1 pika c) dhe d) të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AC.nr. 4492/2014 më dt. 5.09.2017

KRYETARE E KOLEGJIT-GJYKATËSE

Nora Bllaca Dula, d.v.